

Në bazë të Programit për aktivitete në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2023 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 18/22), dhe në lidhje me nenin 4 të Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare (bursa) sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit, për vitin 2023 nr. 08 - 5415/1 data 23.05.2023, Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve financiare (bursa) në vitin 2023 sportistëve – nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit

1. Lëndë e thirrjes publike

1.1. Tema e thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare (bursa) në vitin 2023 sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit, me qëllim rritjen e motivimit të sportistëve të rinj - nxënësit e shkollave të merren me sport, të vazhdojnë dhe të qëndrojnë edhe më tej në sport, si dhe rritjen e përfshirjes të sa më shumë nxënësve për t'u angazhuar në sport dhe aktivitete sportive.

1.2. Mjetet nga pika 1.1 janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2023.

1.3. Ndarja e mjeteve financiare (bursa) në vitin 2023 sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit, përcaktohet me kushte dhe kriteret të veçanta, të cilat janë pjesë përbërëse e Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare (bursa) në vitin 2023 sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit nr. 08 - 5415/1 data 23.05.2023.

1.4. Vlera totale neto e bursës individuale për sportistë - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit është 24.000 (njëzet e katër mijë) denarë me tatim mbi të ardhurat personale të paguar.

2. E drejta për pjesëmarrje në thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë nxënës të rregullt dhe të çrregullt në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit, të cilët plotësojnë kriteret e Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare (bursa) sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit, për vitin 2023 dhe që kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kriteret të përgjithshme

Aplikantët për të fituar të drejtën për bursë, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

- të jenë nënshtrë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të jenë banorë të qytetit të Shkupit;
- të jenë nxënës të rregullt ose të çrregullt në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit;
- të jenë sportistë aktivë dhe anëtarë të klubeve sportive të regjistruar në Regjistrin Qendror me seli në qytetin e Shkupit dhe të jenë përfaqësues shtetërorë të regjistruar në federatat kombëtare sportive përkatëse;
- të kenë arritur rezultate të larta sportive në sportet ekipore dhe individuale nga muaji qershor vitin e kaluar deri në përfundimin e Thirrjes publike të shpallur në vitin në vijim, si më poshtë: medalje të fituara në kampionatet botërore, evropiane dhe ballkanike në sportet olimpikë dhe jo olimpikë, medalje të fituara në kupat botërore dhe evropiane në sportet olimpikë,

fitues të kampionatit vendas apo kupave shtetërore, si dhe të kenë arritur rezultate të larta personale individuale në nivel përfaqësues dhe të kenë vendosur rekorde shtetërore në garat zyrtare.

Të drejtën për bursë mund ta realizojnë maksimumi 4 bursistë të përzgjedhur nga i njëjti sport në konkurrencën për meshkuj dhe femra.

Aplikimet e pranuar hapen, shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i formuar nga kryetarja e Qytetit të Shkupit.

Aplikimet e depozituara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe kriteret për pikët që janë pjesë përbërëse e Rregullores, që do të shpallet në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

Në procedurën e ndarjes së mjeteve financiare (bursa), do të përzgjidhen ata aplikantë të cilët në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe kriteret për pikët të përcaktuara në Rregullore, do të sigurojnë minimumi **50** pikë.

4. Mënyra e aplikimit dhe dokumentacioni i detyrueshëm

Aplikimi në Thirrjen publike kryhet me depozitim të aplikimit të plotësuar plotësisht (aplikimi do të shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk)

Aplikantët që marrin pjesë në Thirrjen Publike, për plotësimin e kriterëve, detyrimisht duhet të depozitojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- kopje nga certifikata e lindjes e aplikantit;
- vërtetim nga shkolla e mesme ku aplikanti është nxënës i rregullt ose i çrregullt në vitin shkollor në vijim;
- kopje nga dëftesa për vitin shkollor të përfunduar më parë;
- vërtetim nga klubi sportiv se është anëtar i të njëjtit;
- vërtetim nga federata kombëtare sportive amë se është përfaqësues shtetëror;
- vërtetim nga federata kombëtare amë për rezultatet e arritura sportive nga muaji qershor i vitit paraprak deri në përfundim të Thirrjes Publike të shpallur në vitin në vijim;
- vërtetim për vendbanim në qytetin e Shkupit;
- kopje e faqes së përparme të llogarisë së transaksionit (vetëm personale e aplikantit, e paautorizuar nga një palë e tretë, dhe nëse aplikanti është i mitur, llogaria e transaksionit duhet të jetë vetëm personale e aplikantit e autorizuar nga prindi/kujdestari)
- dëshmi se janë të regjistruar si tatimpagues në sistemin E-PDD të Drejtorisë së të Ardhurave Publike

5. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

Thirrja publike shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk), në mediet e shkruara (dhe së paku në një gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që flasin më së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja) dhe në mediet elektronike.

Thirrja publike do të shpallet më 22.06.2023 dhe do të zgjasë 12 ditë kalendarike, më së voni deri më 03.07.2023 deri në orën 15:00.

Dokumentacionin e nevojshëm, në zarf të mbyllur, aplikantët e depozitojnë pranë Komisionit nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, ose me postë në adresën: Bulevardi "Ilinden" nr.82, 1000 Shkup, me shënimin: "Sektori për veprimtari publike - Komisioni për ndarjen e bursave sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2023".

Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë aplikantin.

Aplikimi me dokumentacionin e nevojshëm depozitohet në një kopje origjinale, i plotësuar plotësisht dhe i nënshkruar nga aplikanti për bursë.

6. Mënyra e zbatimit të thirrjes publike

Për të përcaktuar plotësimin e kriterëve nga Rregullorja për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare (bursa), kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komisionin për ndarjen e bursave sportistëve - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2023.

Për aplikimet kompletuara, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kriteret e Rregullores, Komisioni i propozon kryetares së Qytetit të Shkupit ndarjen e mjeteve financiare (bursa).

Kryetarja e Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare (bursa).

Komisioni nuk do të shqyrtojë aplikimet e depozituara me vonesë.

Komisioni do të njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar si të pakompletuara, të depozituara jo në kohë dhe që nuk plotësojnë kriteret e Rregullores.

Për informacione plotësuese:

Informacione plotësuese mund të merren në Sektorin për veprimtari publike – Seksioni për sport dhe të rinj në telefonat: 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT